



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr.³⁸..... Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 28 / 03 / 2024

VENDIM

Nr.08, datë 28 /03 /2024

NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR MIRATIM TË NDRYSHIMEVE PËR PROJEKT ZBATIMIN E STRUKTURAVE TË BANIMIT DHE SHËRBIMIT 1-17 KATE NË RRUGËN "KOSOVARËT", TIRANË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) pasi shqyrtoi kërkesën për miratim të Projekt zbatim të strukturave të banimit dhe shërbimit 1-17 kate në rrugën "Kosovaret", Tiranë.

VENDOSI:

- 1- **Të mos e shqyrtojë kërkesën për miratim të ndryshimeve të projekt zbatimit të strukturave të banimit dhe shërbimit 1-17 kate në rrugën "Kosovaret" në Tiranë duke sqaruar Kërkuesin se bazuar në Ligjin Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", Neni 4, KKDM miraton projekt zbatimet e digave të reja si dhe projektet e riparimit dhe përmirësimit të digave që janë në shfrytëzim; Për rrjedhojë duke u bazuar në legjislacionin e mësipërm, KKDM nuk ka kompetenca ligjore të shqyrtojë projekte për objekte që nuk janë pjesë e riparimit apo përmirësimit të digës së liqenit të Tiranës që aktualisht është në shfrytëzim.**
- 2- **Të ri informojmë Kërkuesin dhe Pronarin e digës së liqenit artificial të Tiranës, se KKDM me Vendimin Nr. 04, datë 06.01.2015 i ka konstatuar si absolutisht të pavlefshme Vendimin e KKDM Nr.2, datë 04.07.2014 dhe Vendimin Nr. 3, datë 23.09.2014 për miratimin e Studimit hidroteknik për sigurinë e digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe masat mbrojtëse nga shfrytëzimi i digës.**
- 3- **Të informoj Kërkuesin dhe Bashkinë e Tiranës se bazuar në Ligjin nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", dhe të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Për miratimin e Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave", Pronari ose shfrytëzuesi i objektit (Bashkia Tiranë), mund të paraqesë në KKDM për miratim teknik projekt-idenë ose projektin e zbatimit për ndërtimin ose rehabilitimin e cdo dige që shfrytëzohet prej tyre. Projekti duhet të përgatitet sipas kërkesave të Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave dhe të shoqërohet me studimet mbështetëse dhe dokumentacionin e duhur teknik sipas kërkesave të kësaj Rregulloreje.**

Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyre ekzekutive e KKDM të ndjekë procesin e zbatimit të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI